



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK	Nr. Prot. 03-02/278/17
Dep. DPK	Br. Prot. 03-02/278/17
Nr. i faq. 02	Data 08-02-2017
Broj stranica 02	Datum 08-02-2017
Nr. pages 02	Date 08-02-2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4685/16, për z. Nebih Zariqi – Anëtar Bordi në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4685/16, për z. Nebih Zariqi – Anëtar Bordi në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Zariqi, është hetuar për konflikt të mundshëm interesi sepse krahas ushtrimit të funksionit publik, ka qenë person i autorizuar në biznesin privat N.N.P. “STANDARD” SH.P.K.

Agjencia kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit me të cilën fillimisht ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare. Më pas, z. Zariqi është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për t’i dhënë rekomandimet për ndryshimet që duhet të bëj, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

z. Zariqi është bindur për kufizimin e ushtrimit të funksionit menaxherial në biznesin e tij privat dhe ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për t’u larguar nga ky funksion.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë me të cilën vërtetohet se në biznesin e tij privat ka caktuar një “person të besueshëm”, në cilësinë e personit të autorizuar, ndërsa vet ushtron funksionin e pronarit pasiv. Me këtë ai ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

Shaip Havolli

